

Terma Reference

Ekspert i Jashtëm – Seanca Mentorimi mbi Menaxhimin e Rasteve të Dhunës me Bazë Gjinore (GBV), Ligjin për të Drejtat e Njeriut dhe Praktikën e Punës Sociale

Konsulencë	Ekspert i Jashtëm – Seanca Mentorimi mbi Menaxhimin e Rasteve të Dhunës me Bazë Gjinore (GBV), Ligjin për të Drejtat e Njeriut dhe Praktikën e Punës Sociale Gra Rezistente, Komunitete Rezistente për të Fuqizuar të Mbijetuarat e Dhunës me Bazë Gjinore në Bashkitë Prrenjas, Peqin dhe Belsh
Kohezgjatja e shërbimit	10 muaj
Zona e projektit	Prrenjas, Peqin dhe Belsh
Data e mundshme e fillimit të shërbimit	Shtator 2025 - Prill 2026

Në kuadër të projektit “Gra Rezistente, Komunitete Rezistente për të Fuqizuar të Mbijetuarat e Dhunës me Bazë Gjinore në Bashkitë Prrenjas, Peqin dhe Belsh”, pjesë e projektit “RISE HER - Fuqizojmë gratë dhe vajzat për një jetesë të pavarur”, financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga World Vision Albania dhe Forumi i Gruas Elbasan, me kohëzgjatje 1 Gusht 2025 – 31 Maj 2026, parashikohet angazhimi i një eksperti të jashtëm.

Eksperti do të ofrojë seanca mentorimi mbi menaxhimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore (GBV), të drejtën ndërkombëtare dhe kombëtare të të drejtave të njeriut, si dhe praktikën e punës sociale për anëtarët e Mekanizmave të Referimit të Koordinuar (CRM) në bashkitë Prrenjas, Peqin dhe Belsh. Ky angazhim kontribuon drejtpërdrejt në realizimin e Rezultatit 1 dhe Rezultatit 3 të projektit, duke forcuar kapacitetet institucionale për një reagim të koordinuar, gjithëpërfshirës dhe me qendër të mbijetuesit.

Rreth Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS (shkurtimisht NISMA ARSIS) është një organizatë jofitimprurëse, e cila është themeluar në shkurt të vitit 2016. NISMA ARSIS është një aktor jo qeveritar me influencë në sektorin e shoqërisë civile në Shqipëri.

Misioni i NISMA ARSIS është angazhimi për avancimin e të drejtave të fëmijëve, të rinjve dhe familjarëve të tyre që përballen me vulnerabilitet, duke ofruar shërbime gjithëpërfshirëse dhe duke lehtësuar integrimin me dinjitet të tyre në shoqëri. NISMA ARSIS advokon dhe lobon në nivel lokal dhe qendror mbi çështjet e mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjve, zhvillimit dhe pjesëmarrjes, përmirësimit të kushteve social-ekonomike të familjeve të tyre dhe fuqizimit të kapaciteteve të shërbim ofruesve, organizatave jofitimprurëse, profesionistëve dhe aktorëve të tjerë të cilët punojnë me fëmijët në situatë vulnerabël.

Përshkrimi i Projektit

Projekti “Gra Rezistente, Komunitete Rezistente për të Fuqizuar të Mbijetuarat e Dhunës me Bazë Gjinore në Bashkitë Prrenjas, Peqin dhe Belsh” synon të ulë dhunën me bazë gjinore dhe të promovojë barazinë gjinore përmes fuqizimit të grave të mbijetuara dhe atyre në rrezik, nëpërmjet ndërhyrjeve të drejtuara nga komuniteti. Projekti kombinon menaxhimin e rasteve, këshillimin psikosocial e ligjor,

ngritjen e kapaciteteve për profesionistët lokalë dhe aktivitete ndërgjegjësuere në komunitet. I mbështetur në një qasje të bazuar në të drejtat e njeriut, ai vendos në qendër dinjitetin, fuqizimin dhe pjesëmarrjen e mbijetuarave, duke integruar gjithashtu mjete digjitale për trajnime, akses në informacion dhe lidhje me tregun. Për më tepër, projekti promovon qëndrueshmërinë mjedisore përmes praktikave miqësore me mjedisin në mikro-bizneset e mbështetura.

Objektivat e Angazhimit

Qëllimi i angazhimit është të sigurohet ofrimi i seancave të mentorimit me cilësi të lartë dhe të specializuara për anëtarët e mekanizmave të referimit të koordinuar (CRM) në tre bashkitë target, duke garantuar një qasje të ndjeshme ndaj traumës dhe të mbështetur mbi të drejtat e njeriut.

Roli dhe përgjegjësitë

Eksperti i angazhuar do të:

- Hartojë planin e punës dhe agjendat e seancave të mentorimit në koordinim me ekipin e projektit.
- Zhvillojë gjithsej **24 ditë mentorim** (8 ditë për secilën bashki: Prrenjas, Peqin dhe Belsh).
- Facilitojë seanca pjesëmarrëse, duke përdorur metoda interaktive dhe ushtrime praktike mbi:
 - a. menaxhimin e rasteve të GBV,
 - b. vlerësimin e rrezikut dhe procedurat e referimit,
 - c. parimet e konfidencialitetit dhe qasjen me qendër të mbijetuesi,
 - d. të drejtën e të drejtave të njeriut në praktikën e përditshme,
 - e. praktikatat multidisiplinare të punës sociale.
- Sigurojë dokumente ndihmëse dhe materiale për pjesëmarrësit.
- Përgatisë një **raport përfundimtar**, duke përfshirë një vlerësim mbi angazhimin e pjesëmarrësve, rezultatet e të nxënësve dhe rekomandime për përmirësime të mëtejshme.

Kualifikimet dhe Eksperienca e Kërkuar

Eksperti duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

Arsimi dhe Kualifikimet Akademike:

Eksperti duhet të ketë:

- Diplomë universitare në shkenca sociale, të drejta të njeriut, psikologji, punë sociale ose fusha të ngjashme.
- Minimumi 7 vite përvojë profesionale në fushën e mbrojtjes së fëmijëve, barazisë gjinore, adresimit të dhunës me bazë gjinore ose të drejtave të njeriut.
- Përvojë të provuar në zhvillimin e trajnimeve dhe mentorimeve për profesionistë të vijës së parë dhe institucione vendore.
- Njohuri të thelluara mbi ligjin shqiptar dhe kornizat ndërkombëtare në lidhje me të drejtat e njeriut dhe mbrojtjen nga dhuna me bazë gjinore.
- Aftësi të shkëlqyera ndërpersonale, metodologjike dhe në lehtësimin e proceseve të të nxënësve pjesëmarrës.
- Aftësi raportimi në gjuhën shqipe (njohja e anglishtes është avantazh).

Politikat e Mbrojtjes së Fëmijëve: Të gjithë personat që punojnë me programet e Nisma ARSIS janë të detyruar të respektojnë politikat e mbrojtjes së fëmijëve, politikat e mbrojtjes nga abuzimi dhe

shfrytëzimi seksual, rregulloren e brendshme të Nisma ARSIS, kodin e sjelljes, Legjislacionin e plotë për Mbrojtjen e Fëmijëve si dhe çdo dokument tjetër për të cilin duhet të ketë dijeni.

Koha e mundshme e fillimit të punës është .

Kohëzgjatja e ofrimit të shërbimit është përgjatë periudhës Shtator 2025 - Prill 2026.

Kjo ekspertizë përfshin 24 ditë pune.

Procedura e aplikimit:

Aplikantët e interesuar për të aplikuar për këtë thirrje duhet të dërgojnë me email:

1. CV-në;
2. Letër interesi që shpjegon dhe përvojën në eksperiencë të ngjashme;

brenda datës **04 Shtator 2025** në info@nisma-arsis.org, ose pranë zyrave të Nisma ARSIS: Rr. Sali Butka, Ap.1, Tiranë, Shqipëri.